

Ndihma sociale në Zvicër

Çka ju duhet të dini?!

2

Diskriminimi në paga i grave

Intervistë me sekretaren Anja Peter

3

Shqiptarë dhe 1 Maji në Zvicër

Dallohen Thun-i dhe Schaffhausen-i

4

Nr. 3 | mund 2014 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Iniciativa për pagën minimale

Po mbrojtjes së pagave. Po pagës minimale.



Manifestimi i sivjetmë për 1 maj gjithandej në Zvicër është dominuar nga kërkesa për pagën minimale

A do të aprovohet iniciativa për pagën minimale, nuk na ishte e njohur deri para përmbylljes redaktuese. Megjithatë iniciativa për pagën minimale ka dhënë frytet e saja. Në vijim do të bëjmë një balancë të muajve të fundit dhe përse paga minimale në Zvicër është e nevojshme dhe e zbatueshme.

Me rastin e betejës zgjedhore, kundërshtarët e iniciativës për pagën minimale s'kanë lënë gjë pa ndërmarrë. Thoshin se iniciativa shkatërron vendet e punës, nuk mund ta përballojmë, të rinjtë nuk do të mund më të mësojnë profesionet, pasi edhe ashtu do të ftonin 4000 franga, etj. Mirëpo kjo është thjeshtë frikësim. Pasi një pagë prej 22 frangave në orë, asesi nuk është e tepërt dhe gjithsesi mund të financohet.

Paga minimale ekonomikisht e përballueshme

Për të arritur në përfundim se a është e lartë paga minimale, duhet ti referohemi pagës mesatare. Kjo paraqet

«mesin» e pagave të paguara në një vend, d.m.th. njëra gjysmë fiton më pak, gjysma tjetër më shumë. Paga minimale prej 22 frangave në orë është 61% të pagës mesatare. Vendet tjera si ato skandinave, Franca, apo edhe Turqia kanë një pagë minimale më të lartë në raport me pagën mesatare. Kësaj duhet shtuar faktin se paga minimale ka të bëjë me 9% të punëmarrësve, gjë që ekonomikisht është shumë lehtë e përballueshme.

Para për aeroplan luftarak e jo për paga korrekte?

Nëse flasim për koston, na duhet maturi: 1,6 miliarda franga do të ishte kostoja e përgjithshme ekonomike me rastin e aprovimit të iniciativës për paga minimale. A e dini se sa do të në kushtojë blerja e aeroplanëve luftarak «Gripen»? Së paku 3 miliard franga do të jetë kostoja e përgjithshme, ndërsa mbajtja e pastajme në gjendje të rregullt të tyre, etj., ngrit koston në 10 miliarda franga. Në rast të aprovimit të iniciativës për pagën minimale, do të mund të kursenim 579 milion franga: 300 milion më shumë kontribute të hyra në sigurimet shoqërore, 173 milion më shumë të hyra tatimore

dhe rreth 100 milion më pak ndihmë sociale.

Kundër varfërisë dhe shtypjes së pagave

Kundërshtarët theksojnë me dëshirë, se partneriteti social dhe Kontratave Kolektive të Punës ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme kundër dumpingut në paga dhe kushteve të këqija të punës. Mirëpo, bash tek sektorët e prekur nga pagat ulëta sikur është tregtimi me pakicë dhe floktarët mungojnë Kontratave Kolektive të Punës. Pos kësaj jo të gjitha Kontratave ekzistuese parashohin pagën minimale – shumë Kontratave mungon sigurimi i kërkesave të rëndësishme. Andaj shumë njerëz jetojnë nën minimumin ekzistencial. Organizatat, si ajo Caritas, që kanë shumë përvoja me situatat e dobëta financiare të njerëzve, mbështesin për këto arsye iniciativën në fjalë: Iniciativa paraqet një hap të rëndësishëm për luftimin e varfërisë.

Kujdes zonat e pagave të ulëta!

Unia gjatë zhvillimit të kampanjës votuese ka zbuluar një mori rastesh të pagave të ulëta. Kështu rrjeti i suk-

sesshëm i shitoreve të veshjeve Tally Weil ka marrë një vlerësim negativ për pagat e ulëta, pasi që të punësuarve u ka paguar një pagë minimale dukshëm nën 4000 franga, ndërsa pronarja posedon një pasuri prej 300 miliona frangash. Në radhën e shtypësve të pagave hyjnë edhe transportuesi dhe parlamenti i SVP-së Ulrich Giezendanner, i cili të punësuarve në Tesin u paguan paga «italiane». Apo pronarët e Casa, Els dhe Albert Blokker, të cilët bashkërisht posedojnë një pasuri prej 3 miliarda dollarësh, mirëpo shitëseve të kualifikuara ua paguajnë orën e punës nën 22 franga.

Mundet edhe ndryshe...

Ekziston bindshëm mundësia të paguhen paga korrekte. Gastronomia ka dhënë shembull konkret me ngritjen e pagave radhazi dhe në mënyrë të suksesshme. Ndërmarrjet si Lid, H&M dhe Bata kanë paralajmëruar, se do të ngritin pagën e orës së punës në së paku 22 franga. 4000.– franga vlejné vetëm si markë, si «pak a shumë korrekte» dhe si pagë që siguron ekzistencën. Iniciativa e pagës minimale pra qysh tani ka shënuar sukses!

➔ Aurora García

Editorial



Ksenofobia: Helm shfarosës për Evropën!

Para 100 vitesh, më 1914 me Luftën e parë Botërore pasoi «shekulli i ekstremes». Lufta e parë dhe e dytë Botërore shkatërron Evropën dhe mbyti dhjetëra milion njerëz. Shkaktar ishte vala e paparë e nacional-shovinizmit dhe ksenofobisë. Mësimi i nxjerr nga këto luftëra qoi tek krijimi i Bashkimit Evropian si projekt paqësor. Qëllimi ishte një Evropë sociale. Mjerisht që nga kriza financiare e vitit 2008 BE-ja nuk është më bartëse e shpresës. Në vend se tu kërkohet llogari spekulantëve dhe Bankave, kostoja e fatkeqësisë iu vu për barrë popullatës së vendeve jugore të Evropës. Si pasojë të kësaj gjendjeje kemi një katastrofë sociale: Papunësi rekorde prej 26.5 milion në BE, Papunësi tek rinia në Evropën jugore nga 30–57%, 120 milion evropian/e jetojnë nën kufirin e varfërisë. Mungesa e perspektivës dhe mllëfi i njerëzve shënojnë rritje dramatike. Kjo shpjegon pse ksenofobia dhe nacionalizmi janë bërë tema të zakonshme, ashtu si tregojnë zgjedhjet në vendet e BE-së dhe rezultati i votimit në Zvicër për iniciativën e SVP-së (Partisë Popullore të Zvicrës) më 9.2.2014. Mirëpo historia na e tërheq vërejtjen qartas: ky helm na qon në barbarizëm!

Sindikatat, si forca më e madhe sociale, janë të thirrura të jenë të përgjegjshme dhe nivel të detyrës, që të fitojnë përsëri mendjet dhe zemrat e njerëzve për një Evropë solidare. Vetëm nëse të drejtat elementare sociale vihen para lirisë së tregjeve, vetëm nëse vlen parimi «Paga të njëjta për punë të njëjtë në vend të njëjtë», për të mënjeluar dumpingun në paga, vetëm me një «Marschall-Plan (plan investimi) për Evropë», i cili në mënyrë drastike redukton papunësinë masive, do të ndal rrugën e marrëzisë dhe do të ngjallë përsëri shpresën.

Vasco Pedrina

News

Fitime miliardësh dhe paga të uritura: «Kaktusi i pagave të ulëta» për koncernin e karburanteve ENI

Fletërrufeja «Kaktusi për paga të ulëta» kësaj radhe i takon Koncernit të karburanteve ENI. Përmes një aksioni simbolik në dy pika të karburanteve ENI (ish Agip) në Lozanë, sindikata Unia e Waadt-it bashkë me Unionin e Sindikatave të Zvicrës, kanë denoncuar pagat e ulëta të saj. ENI drejton shumë pika karburantesh në Zvicër, shpesh sipas sistemit ekskluziv. Për të punësuarit kjo d.m.th. pagesë i orës së punës prej 19 dhe 20.50 frangash si dhe kushte të këqija pune të orarit dhe sigurisë në punë. Më shumë informata në: www.lohnenschutz.ch apo www.tieflohnskandal.ch.

«Post-it» për pagën minimale: Gjysmë milion copëza letre për 48 orë

Edhe në ditën e dytë të aksionit kombëtar për pagën minimale më 25./26. prill në shumë vendbanime të mëdha dhe të vogla të Zvicrës janë zhvilluar aktivitete të ndryshme. Kampanja shumëmilionëshe e kundërshtarëve përballet me angazhimin e madh të aktivisteve e aktivistëve të Unia-s, të cilët me të gjitha forcat përpiqen ti bindin qytetarët për një PO me 18 maj. Pos kësaj në kuadër të aksionit «Post-it për paga korrekte» janë ngjitur në kutitë e postës 600000 copëza letre me ketë mesazh, për të bërë reklamë për pagën minimale.

Studimi i ri tregon: Hendeku në paga zgjerohet edhe më tej dhe mosbarazimi në paga rritet

Rezultatet e para të studimit të publikuar mbi anketimin i strukturave të pagave (LSE) të Entit Federal për Statistika tregojnë shumë qartë, se sa e rëndësishme është paga ligjore minimale prej 4000 frangave. Kështu gërshëra mes grupeve me të ardhura më të larta dhe atyre më të ulëta po zgjerohet edhe më tej. Edhe pabarazia në paga mes burrave dhe grave është rritur krahasuar me vitin 2008 edhe më tej. Diskriminimi në pagave të grave ishte gjithashtu temë në konferencën vjetore të Unionit të Sindikatave të Zvicrës me rastin e 1 Majit. Për Unia-n, Vania Alleva theksoj nevojën që Kontrata Kolektive e Punës dhe paga minimale të shërbejnë si instrument për reduktimin e diskriminimit në paga. Për të është e qartë: Më 18 maj ne mund të bëjmë një hap të madh përpara për paga korrekte për të gjithë.

Ndihma sociale

Ndihma sociale: Çka duhet të dini

Kush jeton nën minimumin jetik, ka të drejtë për ndihmë sociale. Mirëpo janë shumë gjëra për të cilat duhet të keni kujdes. Në vijim ne sqarojmë, kush ka të drejtë për ndihmë sociale dhe si duhet ta kërkonti atë.

Kush jeton nën minimumin jetik, ka të drejtë për ndihmë sociale. Mirëpo janë shumë gjëra për të cilat duhet të keni kujdes. Në vijim ne sqarojmë, kush ka të drejtë për ndihmë sociale dhe si duhet ta kërkonti atë.

Hapi i parë: Rishikimi i buxhetit

Për të vlerësuar se a posedoni fare të drejtë për ndihmë sociale, hartoni së pari një buxhet tuajin. Ju duhet të veni përballë njëra tjetrës jo vetëm të ardhurat dhe shpenzimet e juaja. Mendoni edhe në provizionet e papara (për shembull faturat e dentistit) dhe planifikoni, se sa duhet të paguani për tatim dhe sa para duhet lënë anash për të larë borxhet. Me këtë rast mund të ju ndihmojë Këshillimorja për planifikim buxheti. Përmes këshillave (mjeteve ndihmëse) online dhe fletëpalosjeve (shih: www.budgetberatung.ch) mund të përlllogaritni edhe vet buxhetin tuaj. Caktimi një termin tek këshillimorja në afërsi tuajën. Ato këshillojnë falas. Adresat mund ti në faqen e lartshënuar të internetit.

Shërbime tjera?

A ka rezultuar rishikimi i buxhetit se keni para të pamjaftueshme? Atëherë si hap të ardhshëm duhet të kontrolloni shërbimet e ndryshme suplementare, për të cilat duhet të aplikoni. Këtu hyjnë bursat, reduktimet e premive për arkat shëndetësore, shtesat familjare edhe për të papunët apo një paradhënie për alimentacionin e fëmijëve, nëse ato nuk ju paguhen me rregull. Vetëm nëse parat edhe me këto plotësime nuk mjaftojnë mund të llogarisni se ndoshta posedoni të drejtën në ndihmë sociale.

Minimumi jetik

Nëse jetoni nën minimumin jetik, merrni ndihmë shtetërore. Minimumi jetik

përcaktohet duke bërë bashkë nevojat themelore, përkujdesen themelore medicinale dhe shpenzimet për banim (qiraja dhe shpenzimet shtesë). Lartësia e ndihmës sociale është e përcaktuar varësisht nga Kantoni dhe mund të jetë shumë e ndryshme. Edhe nevojat themelore ndryshojnë nga Kantoni në Kanton, pasi jo të gjitha kantonet marrin parasysh shtrenjtimit. Nevojat themelore llogariten në bazë të madhësisë së familjes suaj. Udhëzimet përcaktuese i gjeni nën: <http://goo.gl/lvc0Xg> (gjermanisht), <http://goo.gl/KslJ8h> (frëngjisht), <http://goo.gl/ofZJYt> (italisht)

A duhet të përdori kursimet e mija?

Po. Para se të keni të drejtë për ndihmë sociale, duhet të përdorni pasurinë tuaj deri tek një shumë të tolerueshme. Kjo shumë për individë është 4000 franga, për çifte 8000 franga dhe për çdo fëmijë nën moshën madhore plus 2000 franga (deri maksimalisht 10000 franga për familje).

Si pasuri llogaritet gjithçka që mund ta përdorni për jetesën tuaj. Këtu nuk llogariten vetëm letrat me vlerë dhe parat e gatshme, porse shembulli bie

patundshmëria apo automobili. Vetëm gjërat e juaja personale dhe pajisjet shtëpiake nuk llogariten. Andaj është shumë mundshme që ju duhet ta shitni automobilin e juaj, para se të fitoni të drejtën ndihmës sociale. Nëse megjithatë ju nevojitet automjeti juaj për të shkuar në punë, ndoshta do të mund ta mbani.

A më duhet të shes shtëpinë?

Jo gjithsesi. Banesa si patundshmëri në thelb llogaritet si pasuri juaja. Mirëpo nëse në shtëpinë tuaj jetoni më lirë se sa në një banesë të marrë me qira, sipas të gjitha gjasave mund ta mbani atë.

Të lëshoj punën?

Jo, në asnjë rast. Kush shembulli bie punon 40% dhe fiton 1000 franga, guxon të mbajë si tolerancë për veti. Pjesa tjetër hiqet nga shërbimet e ndihmës sociale. Toleranca ndryshon varësisht nga vendbanimi. SKOS- Konferenca Zvicerane për Ndihmë Sociale (shih tabelën e mëposhtme) urgjentisht ju këshillon të mos hiqni dorë nga veprimtaria e punës. Kështu ruani të ardhurat nga puna dhe mbeteni aktiv në tregun e punës.

A duhet të paguajnë familjarët e mi për mua?

Ekziston obligimi i mbështetjes i familjarëve. Për ti obliguar familjarët për të ndihmuar, duhet të jeni të familjarizuar me ta në vij të drejtpërdrejt. Kjo d.m.th. prindërit, gjyshet/rit, fëmijët, nipat/mbesat duhet të mbështeten mes veti. Mirëpo, jo tezet e hallat, axhët e datat apo kushërinjtë, etj. Por mbështetja e familjarëve vlen vetëm nëse familjarët jetojnë në kushte të mira financiare. Këto kushte do të rishikohen në secilin rast të veçantë. Për një kontribut mbështetës pos tjerash është i nevojshëm një vendim gjyqësor.

A duhet ti deklaroj të gjithat?

Po. Nëse kërkonti ndihmë sociale, duhet të jepni informata për të gjitha të ardhurat, pasurinë dhe marrëdhëniet familjare. Ju duhet ti dëshmoni e deklaroni edhe dëftesat e rrogave, faturat e qerasë së banesave dhe dëftesat e bankës. Dhe nëse gjendja juaj financiare dhe familjare ndryshon, atëherë këtë duhet t'ia komunikoni menjëherë Entit kompetent social.

© Sina Bühler, përshtatur nga work, Nr. 5/ 21. mars 2014



Mungesa e informatave dhe njohurive mund të qojë në qorrsoak

SKOS-Udhërrëfyeni i Konferencës Zvicerane për Ndihmë Sociale

Konferenca Zvicerane për Ndihmë Sociale (SKOS) është asociacioni për ndihmë sociale në Zvicër. SKOS-i ka mbi 50 vite që përpunon udhërrëfyesin, përmes të cilit maten shërbimet e ndihmës sociale. Këto janë vetëm rekomandime, mirëpo shumica e anëtarëve (Entet Sociale) i përmbahen këtyre. Udhërrëfyeni aktual i SKOS-it dhe përgjigjet në pyetjet më të shpeshta mbi ndihmën sociale i gjeni në faqen e internetit www.skos.ch.

Apelimi

Nëse e merrni një vendim nga zyrtarët, me të cilin nuk pajtoheni, mund të apelonit. Keni parasysh gjithmonë afatet! Vendimet e tilla zyrtare i merrni në formë të shkruar. Në to qëndron edhe mësimi mbi rrugën ligjore. Gjithashtu aty gjeni edhe afatin dhe faqja zyrtare ku duhet të adresoni apelimin. Për apelim në shumicën e rasteve nuk keni nevojë për avokat, pasi mund të ju mbështesin mjaftueshëm edhe këshillimoret juridike apo ato sociale. Mos u trembni apo frikësoni. Kryesisht tek qiraja apo trajtimi i dhëmbëve ndihma sociale mohan shpesh mbështetjen. Mbrohuni dhe kundërshtoni në raste të tilla dhe ankohuni përmes apelimit.

Largim masiv nga puna në industri

Të punësuarit në Bacab: Greva ia ka vlerë!

Pas një greve gati 5 javor, rreth 40 të punësuarit në firmën për prodhimin kabllove për nxehe Bacab AG në Ste. Croix (Vaud) kanë vendosur, të kthehen në vendet e punës. Ata pas marrjes së lajmit për mbylljen e fabrikës prodhuese janë angazhuar suksesshëm për një plan më të mirë social.



Aksion protestues i punonjëve të prekur



Pamje tjetër nga protesta e të punësuarve

Në fillim të muajit prill rreth 40 punonjës të firmës së specializuar për prodhimin e kabllove për nxehe Bacab në Ste. Croix (të kantonit Vaud) hynë në një grevë të pa afatizuar. Kështu ata protestuan kundër planit krejtësisht të papranueshëm social, të cilin e prezantoi firma që i takon koncernit gjerman Bartec. Firma Bacab, gjegjësisht Bartec në fillim të prillit komunikoi që prodhimi i kabllove për nxehe do të zhvendoset përfundimisht në Gjermani.

Plani i përmirësuar social

Më 9 prill falë presionit të grevistëve, drejtuesit e ndërmarrjes kanë paraqitur një plan të ri social. Kompensimi për pushim nga puna në krahasim me planin fillestar tani ishin mbi dyfishin e kaluar. Plani i ri social parashihet mesatarisht pesë në vend të dy pagave mujore. Të punësuarit kanë pranuar ofertën.

Rreth 32 të punësuar humbin vendin e punës

Të punësuarit, pas marrjes vesh të planit të ri social, kanë nisur përsëri punën prodhuese të kabllove për nxehe në Ste. Croix (VD). Zhvendosja definitive e prodhimit është paraparë për fund të muajit maj 2014. Nga rreth 40 të punësuarve, vendin e tyre të punës do ta humbin 32 punonjës. Në këtë vendndodhje do të vijojnë të mbesin të punësuar vetëm 8 veta për blerjen e lëndës së parë dhe ambalazhimin e produkteve.

Aurora García

KKP për përkujdesën privat të të moshuarve

KKP e re për përkujdesën privat të të moshuarve

Shoqata «jeta në shtëpi» dhe sindikata Unia pas 1 viti e gjysmë negociatash janë pajtuar për një Kontratë Kolektive të Punës (KKP) në sektorin e përkujdesjes private të pleqve në pjesën e Zvicrës gjermane. KKP ka për qëllim mbrojtjen dhe realizimin e kërkesave të punëmarrësve si dhe sigurimin e përkujdesjes e vlefshëm kualitative në shtëpitë private. Rezultatet e bisedimeve kanë mbetur të ratifikohen nga institucionet përgjegjëse.



KKP-ja siguron zhvillimin profesional dhe kualitetin e përkujdesit

Kontrata Kolektive e Punës duhet të vlejë për ndërmarrje dhe agjenci private që nuk kanë dobi shoqërore në Zvicrën gjermane, e të cilat veprojnë në sektorin e shoqërimin dhe përkujdesjes jo medicinale e të moshuarve nëpër shtëpitë private. Organizatat publiko juridike si dhe ato me dobi shoqërore të ngarkuara me marrëveshje shërbyese nga paraja publike janë të përfshyera nga kjo Kontratë.

Sukses i madh

Kjo Kontratë e re Kolektive e Punës është një hap i madh përpara, e cila si e tillë punëmarrësve në këtë sektor në rritje e sipër u ndihmon për një

mbrojtje më të mirë. Andaj edhe partnerët kontraktues kanë vendosur të aplikojnë në Sekretariatit ekonomik shtetëror (Seco) për ta deklaruar këtë Kontratë si të detyrueshme.

Pagat minimale

Kjo Kontratë Kolektive e Punës ndër të tjera përcakton edhe pagat minimale. Paga minimale për kategorinë e të «pa kualifikuarve» duhet që deri në vitin 2018 hap pas hapi të rritet në 22 franga për orë pune. Për kategoritë tjera të rrogave Kontrata Kolektive njih aspektet e aftësimin profesional dhe arsimimin e mëtejshëm. Rroga e 13-të gjithashtu është e ankoruar në Kontratë.

Koha e mungesës dhe instancat kontrolluese

Temat e rëndësishme të këtij sektori si koha e punës dhe pushimit, kompensimi për kohën e rrugën për në punë si dhe gatishmëria për punë janë të rregulluara me këtë Kontratë. Është paraparë edhe sigurimi i parave ditore në rast sëmundjeje. Sikur Kontratata tjera Kolektive të Punës edhe kjo parashihet instancat e paritetit, të cilat kontrollojnë respektimin e Kontratës. Pos tjerash do të zhvillohet edhe aftësimi i mëtejshëm profesional. Kështu sigurohet jo vetëm ardhmëria profesionale e punëmarrësve, porse edhe kualiteti i pakujdesjes.

Aurora García

Intervistë

It's bread we fight for – but we fight for roses, too!



Anja Peter, sekretare për barazi në Unia

«Pagat e grave janë diskriminuuese dhe ilegale»

Më 28 prill është publikuar hulumtimi mbi strukturën e pagave për vitin 2012, e cili ka analizuar zhvillimin e pagave në sektorin e ekonomisë private. Përfundimet e tij janë shqetësuese: Dallimi në paga mes burrave dhe grave, i zvogëluar deri në vitin 2010 ishte dalëngadalë, tani përsëri është rritur. Rishtas gratë fitojnë gati 19% më pak se kolegët e tyre burra, të cilët kryejnë po të njëjtën punë. Horizonte ka biseduar me Anja Peter, sekretare për barazi në Unia.

Dallimi në paga mes grave dhe burrave është rritur përsëri.

Cili është reagimi yt për këtë?

Është e turpshme! Ne kemi një nen kushtetues dhe një ligj që kërkojnë pagë të njëjtë për punë të njëjtë. Sipas tyre grate e burrat janë të barabartë në të gjitha fushat shoqërore. Si duket ky fakt nuk iu është i njohur të gjithëve. Punëdhënësit shovinist, si rasti i Roland Müller-it (Drejtori Shoqatës së Punëdhënësve), shkon aq larg sa për stërkeqen e pagave fajn ua hedh grave. Gratë kryejnë punë të rëndësishme për shoqërinë tonë. Ato kujdesen për punët e shtëpisë dhe për rritjen e edukimin e fëmijëve. Pos kësaj ne përkujdesemi edhe për të familjarët e moshuar dhe ata të sëmurë dhe vetëkuptueshëm edhe jemi të punësuar. Përkundër tërë këtyre kontributeve, gratë vazhdojnë të diskriminohen.

Cilat gra janë të prekura nga diskriminimi në paga?

Të gjitha gratë janë të prekura. Dallime në paga ka në të gjitha sektorët dhe profesionet. Gjithashtu dhe në rrafshin e kualifikimeve profesionale dhe nivelet e hierarkisë. Edhe drejtorja e një banke fiton më pak se kolegu i saj i gjinisë mashkullore. Llogaritur në pagën mujore, gratë fitojnë mesatarisht 1800 franga më pak sesa burrat. Këto janë shumë para. Punëmarrësit u mbesin borxh grave për rreth 8 miliarda franga në vit.

Cilët sektorë janë veçanërisht të prekur nga diskriminimi në paga?

Diferenca në paga është më e vogël në sektorët me pagë minimale sipas KKP-së. Shembulli bie në Gastronomi: KKP parashihet pagën minimale për të gjithë të punësuarit. Këtu diskriminimi në pagë është dukshëm më i vogël se sa në tregtinë me pakicë. Andaj KKP-të me paga minimale janë të rëndësishme për gratë. Paga minimale prej 22 Fr. për orë pune, i mundëson 230000 grave ngritje page. Është vendimtare që të gjitha gratë të votojnë PO pro pagës minimale.

Shumë punëdhënës theksojnë se duan të respektojnë barazinë në paga?!

Mirëpo nuk iu përmbahen kësaj. Këtë tregojnë shifrat e studimit të lartpërmendur. Të dhënat bazohen në anketimet nëpër ndërmarrje. Ekziston ligji që ndalon diskriminimin e grave në paga, ndërsa punëdhënësit përditë thyejnë ligjin, pa drojë për konsekuenca. Unia kërkon ndryshimin ligjit, për ti kontrolluar pagat dhe për të dënuar punëmarrësit që gabojnë.

A ka hulumtimi në fjalë përfundime pozitive në raport me gratë?

Tendenca në rritje e kuotës së grave të punësuar. Edhe nënat sot janë më të integruara në tregun e punës. Mirëpo ka probleme tjera pasi gratë janë të punësuar me orar të kufizuar. Shpesh kjo është mundësia e vetme për ti akorduar detyrimet familjare dhe ato profesionale. Punësimi i kufizuar bie më pak të ardhura, më pak karrierë dhe mundësi zhvillimi profesional, më pak përgjegjësi drejtuese. Shpesh gratë punojnë në profesione me paga tejet të ulëta, si kujdestare të pleqve dhe të të sëmurëve, në floktari, apo në shitje. Pagat de ulëta nuk janë rastësi. Sa më i madh numri i grave në një sektor, aq më të ulëta pagat në atë sektor. Kështu edhe në pleqëri gratë dënohen prap, pasi marrin pension shumë të ulët. Kjo s'është e drejtë, pasi gratë bëjnë punë të mirë dhe të rëndësishme! Unia luftoj për njohje të kësaj pune dhe të ardhura më të larta për punën e grave.

Marrëveshja Sociale me Zvicrën temë në festën e një majit në Thun

Ti ipet fund diskriminimit të shtetasve të Kosovës

Për ditën e punëtorëve, 1 Majin, në Thun (Bernë), në sheshin përpara Parlamentit të Qytetit ishin tubuar disa qindra njerëz të gjeneratave të ndryshme. Programi i festës ishte i pasur me fjalime, humor, këngë e valle, ushqim dhe pije. Mysafiri më i lartë në këtë festë tradicionale është Ministri Alain Berset.

Në këtë manifestim tradicional marrin pjesë edhe fëmijët e grupit të valltarëve të shoqatës «Atdheu» nga qyteti i Thunit, të cilët paraqiten me dy-tri valle tradicionale shqiptare. Ndoshta edhe kjo e ka shty Ministrin Berset, që në fillim t'i thotë edhe disa fjalë përshëndetëse në gjuhën shqipe, ku thotë: «Të dashura kolege, të dashur kolegë. Kam knaqësinë e madhe, që jam sot me ju në Thun dhe të ju drejtohem me disa fjalë për një majin. Faleminderit shumë për golat e shënuar, respektivisht për mbrojtjen e golave kundër ekipit tanë». Ministri Berset vazhdon pastaj në gjuhën gjermane, dhe përmend kontributin, të cilin e japin migrantet dhe migrantët në ndërimin e Zvicrës.



Marshimi tradicional në qytetin e Schaffhausenit i prirë nga organizatorët dhe oratorët e manifestimit



Blerta Neziri i dorëzoi Ministrin Berset shkresën për Marrëveshjen mbi Sigurimet Sociale me Kosovën

Valle shqipe dhe një fjalim i preکشëm me një apel

Pas fjalimit të Ministrin Berset, grupi i fëmijëve vallëzon dy valle burimore shqiptare dhe pastaj në foltore del Blerta Neziri, nxënëse nga Thuni dhe lexon një apel drejtuar Ministrin Berset, të nënshkruar nga të gjithë fëmijët, të cilët kanë vallëzuar aty. Në vazhdim po e japim përmbajtjen e plotë të fjalimit:
«I nderuar Ministër, i dashur Alain. Na vjen mirë që jeni këtu me ne. Shpresojmë se ju ka pëlqyer vallja. Ne jemi të lindur në Zvicër dhe këtu e ndjekim shkollimin. Ne po ashtu jemi të lumtur që jetojmë në Zvicër. Gjyshërit tanë kanë punuar për këtë Zvicër. Prindërit tanë punojnë sot dhe në të ardhmen do të punojnë edhe ne. Vetëm së bashku mund ta çojmë Zvicrën përpara. Ne e kemi këtu një letër për ju me një lutje: Edhe përkundër faktit se gjyshërit dhe prindërit tanë kanë punuar këtu dhe kanë paguar kontributet për AHV dhe IV (pensione të moshës

dhe të trashëgimisë si dhe pensione të invaliditetit), ata, në pleqëri dhe në kushte invaliditeti po përballen me shumë vështirësi. Ja përse është kështu. Para katër vitesh Qeveria Federale pati vendosur të mos e vazhdojë marrëveshjen për sigurimet sociale me shtetin e ri, Kosovën. Kjo sjell me vete shumë pasoja të rënda për personat e goditur. Ne në letër kemi përmendur disa shembuj. Këtu po e përmendi vetëm një shembull: Një baba vdes në një aksident pune. E veja dhe fëmijët ende të mitur kanë leje qëndrimi. Pasi që pensioni është tepër i vogël, atyre nuk u vazhdohet qëndrimi dhe detyrohen të lëshojnë Zvicrën. Dhe tash kur ata janë jashtë Zvicrës, nuk u jepet pensioni për faktin se jetojnë në Kosovë. Kjo është çnjerëzore dhe jo korrekte. Ju lusim që ta lexoni letrën personalisht dhe pastaj të veproni. Jepiani një fund këtij diskriminimi. Ju falënderojmë!»

Ministri e pranon letrën

Menjëherë pas leximit të këtij apeli, Blerta nisët në drejtim të Ministrin Berset, i cili qohet nga vendi i tij dhe bën ca hapa në drejtim të Blertës. Publiku i mbledhur në festë e përcjellë këtë skenë me duartrokitje. Blerta ia dorëzon Ministrin Berste një zarf dhe ata ndrojnë disa fjalë. Sipas Blerta Nezirit, Ministri Berset i ka thënë asaj se e njej mirë gjendjen në Kosovë dhe do të mundohet të ndryshoj gjendjen e tashme. Pas ndërrimit të këtyre fjalëve ata ndahen nga njëri tjetri. Blerta në drejtim të grupit të fëmijëve, Ministri Berset ulet prapë afër mysafirëve tjerë dhe këshillëtarit të tij. Letra e Blertës me nënshkrimet e fëmijëve duket se atyre u bën përshtypje të madhe.

Hilmi Gashi

Bashkë-drejtues në Unia Berner Oberland



Aktivistët shqiptarë kundërshtojnë tjetërsimin e pasurisë kombëtare në Kosovë

1 maji në Schaffhausen

Pjesëtarët e komunitetit shqiptar janë tradicionalisht pjesë aktive e manifestimit të 1 majit në disa qytete të Zvicrës. Kështu edhe sot aktivistet e Bashkësisë Shqiptare të Schaffhausen-it defiluan bashkë me Faton Topallin, deputet i Lëvizjes Vetëvendosje! në Kuvendin e Republikës së Kosovës si dhe me kolegët zviceran e tjerë të huaj. Shqiptarët fillimisht gjatë marshimit tradicional, vunë në thumb procesin e shpronësimit dhe tjetërsimit abuziv të pasurisë shoqërore dhe kombëtare të Kosovës, përmes transparenteve në gjuhën shqipe dhe gjermane «Stop shpronësimit dhe abuzimit të pasurisë publike dhe shoqërore të Kosovës».

Pasojat konkrete për qytetarët e Kosovës në Zvicër

Më pas, menjëherë pas dy fjalimeve kryesore sekretari sindikal i Schaffhausen-it, kolegu Andres Scheu pjesëmarrësit e manifestimit të 1 Majit i vuri në dijeni për një rast keqtrajtimit e një qytetari të Kosovës dhe u kërkua nga të pranishmit që në shenjë solidariteti të nënshkruajnë peticionin e sindikatës Unia drejtuar zyrtarëve të qytetit të Schaffhausen-it. Ky rast është një shembull që pasqyron pozitën dhe situatën tejet të papëlqyeshme të qytetarëve të Kosovës në Zvicër, si rrjedhojë e mungesës së zbatimit të Marrëveshjes Sociale mes Zvicrës dhe Kosovës, të ndërlydhura edhe me përkeqësimin e ligjit për të huajt dhe përkujdesen social gjatë procedurës së pensionit të invaliditetit e që me veti bie edhe pasoja të mëdha përcjellëse për të prekurit. Më pas për bashkëkombësin dhe kolegun tonë Flurim Thaqi u mblodhën mbi 210 nënshkrime për Peticionin drejtuar zyrtarëve të qytetit Schaffhausen.

Osman Osmani, Sekretar për migracion në Unia



Kolona e dytë:

Isha i papunë. A isha gjatë kësaj kohe detyrimisht i siguruar për moshë pleqërie?

Kam punuar për shumë vite si kontabilist në një ndërmarrje industriale. Pasi që në vitet e fundit gjendja e mandateve u përkeqësua, mua më pushuan nga puna dhe isha për 4 muaj i papunë. Fatmirësisht tani kam përsëri një vend pune. Mirëpo pyes veten se çka ka ndodhur me sigurimin tim profesional të pensionit gjatë papunësisë sime. A kam kursyer në këtë kohë për moshën time të pleqërisë?

Jo. Të gjithë personat e papunë edhe pse janë detyrimisht të siguruar për rreziqet e invaliditetit dhe vdekjes, mirëpo nuk janë të siguruar për pleqëri. Si kornizë kufizuese e përfshirëse në sigurimin pensional profesional, tani për tani vlen paga minimale ditore prej 80.90 frangave (21.060 franga në vit). Kjo d.m.th. të papunët që marrin një kompensim nga arka e sigurimit të papunësisë mbi 80.90 frangave në ditë, janë të obliguar të paguajnë kontribute në kolonën e dytë. Personi i siguruar bashkë me sigurimin e papunësisë paguajnë përgjysmë kontributet. Nëse qysh në muajin e parë kur keni mbet i papunë nuk jeni lajmëruar në arkën e sigurimit të papunësisë, atëherë keni qenë i siguruar në arkën pesionale kundër invaliditetit dhe vdekjes. Më pas sigurimi vijon të vazhdojë në Fondi përfshirës i sigurimit pensional profesional, mirëpo pa sigurimin e pensionit të pleqërisë. Kursimet tuaja të deriatëhershme me rastin e largimit nga puna deponohen në një konto të veçantë sipas përzgjedhjes suaj. Tani shuma e kursyer i bartet institucionit të sigurimeve pensionale profesionale të punëdhënësit tuaj të ri, ku vijon të vazhdojë sigurimi i juaj gjegjës.

Thomas Baumgartner, work, 3.4.2014

Kolona e dytë:

Sigurimi vullnetar

Ka një muaj që marrë paratë ditore nga arka e sigurimit të papunësisë dhe dua të paguaj vullnetarisht më tej kontributet në sigurimin e pleqërisë. A është kjo fare mundur?

Po, gjatë papunësisë ekziston mundësia, të vazhdoni vullnetarisht të paguani kontributet kursyese për pleqëri, ose tek Fondi përfshirës gjegjës ose tek arka e juaj e pensionit – po që se lejohet me rregulloren e ati sigurimi. Premitë e sigurimit të pleqërisë së kolonës së dytë duhet ti mbuloni tërësisht ju vet. Sa i përket Fondit përfshirës të sigurimeve pensionale profesionale, aty keni mundësi të ndryshme të sigurimit vullnetar. Si përfitues i parave ditore nga arka e papunësisë jeni detyrimisht të siguruar kundër rreziqeve të invaliditetit dhe vdekjes. Në planin përkujdesjes pensionale (WO) mund të vazhdoni vullnetarisht sigurimin e përkujdesjes së pleqërisë (procesi i kursimit). Ju keni edhe mundësinë, përkujdesjes e juaj të pleqërisë ta vazhdoni me lirimin nga kontributet. Informata nëmte detajuar për mundësitë e ndryshme mund ti gjeni në: <http://www.chaeis.net/bvg-berufliche-vorsorge/einzelpersonen/anmeldung.html>.

Nëse jeni të interesuar të vazhdoni vullnetarisht sigurimin pensional profesional të pleqërisë në bazë të kolonës së dytë, duhet në veçanti të kujdeseni që dokumentacioni i aplikimit të arrijë në Fondin enkas përfshirës më së largu 90 ditë nga dalje prej sigurimit të detyrueshëm pensional profesional.

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. Garcia, D. Filipovic, E. Sariassian, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.

www.unia.ch